



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 13.03.2018

Dokument parlamentar

(Komisioni përgjegjës)

R A P O R T

Për projektligjin

Për miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, miratuar me ligjin nr.104/2015, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 21 shkurt 2018, filloi shqyrtimin e projektligjit “Për miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, miratuar me ligjin nr.104/2015, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”. Duke qënë se nga Kuvendi, ishin konstatuar disa gabime aritmetikore në tekstin e marrëveshjes dhe në kushtet kur korrektimi i saj nuk ishte paraqitur në formën e kërkuar, nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave u la detyrë risjellja e korrektimit në mënyrë korrekte nga Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Ministrave përmes shkresës nr. 6625/5 datë 28.02.2018 (nr. 319/2 Prot. Kuvendi) datë 01.03.2018), ka paraqitur pranë Kuvendit marrëveshjen e korrektuar.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat në mbledhjen e datës 6 mars 2018, shqyrtoi në parim, nën parim dhe në tërësi projektligjin “Për miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, miratuar me ligjin nr.104/2015, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”. Procedura e shqyrtimit të projektligjit u mbështet në nenet 32-39, të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjet e komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Z. Roland Xhelilaj.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenin 78 dhe nenin 83 pika 1 të Kushtetutës dhe miratimi i tij i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Ky projektligj konsiston në miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”, miratuar me ligjin nr.104/2015.

Projektligji ka për qëllim garantimin e funksionimit të linjës principiale teknologjike, të paraqitur në kontratën fillestare, nga kushtet e paparashikuara teknike, që lidhen me marrjen e masave për mbrojtjen nga dinamika e shumëllojtë e fundit të detit në këtë zonë. Masat teknike të provuara në procesin e implementimit të projektit kanë treguar se nuk garantojnë zbatimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të linjës teknologjike dhe për këtë arsye nevojiten ndryshime të elementeve të veçantë të strukturës së objekteve, me qëllim realizimin e tij. Në këtë mënyrë do mundësohet përdorimi i plotë i objektit të kontratës dhe ofrimi i shërbimit të dhënies me koncesion. Gjithashtu për të garantuar një qëndrueshmëri të argjinaturës dhe strukturës së tubacioneve ajrore në këtë argjinaturë, në bazë të studimeve, është konkluduar se është i nevojshëm një mjet tjetër mbrojtës (dallgëthyes) me të njëjtin profil tërthor e shpatulluar në vendin më të afërt të kodrës përballë në anën jugore të linjës. Sipas mendimit edhe të projektuesit, kjo argjinaturë garanton teknikisht linjën teknologjike mbi tokë të Portit të hapur MBM.

Përmes kësaj shtese kontrate, vlera e rishikuar e investimit do të rritet me 4 300 000 USD duke arritur një vlerë totale prej 14 500 000 USD.

Ndryshimi i propozuar nuk ndikon në pranimin e ngarkim-shkarkimit të mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure të madhësive mbi 20 000 tonë dhe as nivelin e zhytjes së anijeve që transportojnë hidrokarbure me zhytje mbi 8 metra.

Shtesa e kontratës është e përbërë nga pjesa përshkruese dhe përmban, gjithsej, 5 nene dhe shoqërohet edhe nga anekset përkatëse

- Neni 1 i marrëveshjes, bën reflektimin e ndryshimeve të nevojshme në vlerën e investimit, pas miratimit të ndryshimeve në projekt.
- Neni 2 mundëson ndryshimin e aneksit 1 me aneksin 1/1 bashkangjitur këtij projektligji në të cilin përfshihen ndryshimet e nevojshme në skemën e projektit të koncesionit.
- Neni 3 mundëson ndryshimin e aneksit 3 me aneksin bashkangjitur projektligjit.
- Në nenin 4 përcaktohen detyrimet ndaj shoqërisë koncesionare, për zbatimin e legjislacionit në fuqi mbi peshkimin dhe atë mjedisor si dhe çdo detyrim e angazhim tjetër, të marrë përsipër në kontratën koncesionare gjatë gjithë kohës së ndërtimit dhe operimit të koncesionit.
- Në nenin 5 përcaktohet koha e hyrjes në fuqi të kontratës.

IV. Diskutimet në komision

Përqafësuesi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë gjatë prezantimit të projektligjit u shpreh se ndryshimi i marrëveshjes koncesionare bazë është iniciuar përmes kërkesës/shkresës nr.1761 prot., datë 10.11.2017, së shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”. Përmes kësaj kërkesë, evidentohet fakti se që në fazën përgatitore për shtrirjen e dy tubave në det është vënë re që niveli i tabanit të detit është shumë i ndryshueshëm nga aluvjonet që vijnë nga hidrovori i Porto-Romanos, i cili derdhet në krah të tubacioneve. Kjo gjendje e bën linjën e tubave të paqëndrueshme dhe të rrezikuar nga dallgët e detit. Të gjendur para këtij fakti, në konsultim edhe me studio prestigjioze në Evropë, të specializuara në këtë fushë, është menduar që t’i bëhet një shtesë projektit për kalimin e kësaj zone me tubacione mbi një argjinaturë artificiale. Shtesa ka qëllim të vetëm garantimin e funksionimit të linjës principiale teknologjike, të paraqitur në kontratën fillestare, nga kushtet e paparashikuara teknike, që lidhen me marrjen e masave për mbrojtjen nga dinamika e shumëllojtë e fundit të detit në këtë zonë.

Grupi i punës i ngritur për shqyrtimin e kësaj kërkesë pas analizimit të saj konstatoi se ndryshimet e propozuara nuk ndryshojnë kushtet thelbësore të kësaj kontrate, që janë të përcaktuara në dispozitat e kontratës koncesionare dhe që kanë shërbyer si bazë për garën koncesionare dhe për përzgjedhjen e koncesionarit fitues dhe për këtë arsye nuk është e nevojshme zbatim i një procedure të re të dhënies së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat. Vlera e rishikuar e investimit do të rritet me 4 300 000 USD duke arritur një vlerë totale prej 14 500 000 USD, e cila shpërndahet sipas zërave të mëposhtëm:

- Studim dhe zhvillim paraprak me vlerë 153 000 USD (vlera është e njëjtë me atë të kontratës fillestare);
- Faza përgatitore e terrenit me vlerë 6 903 000 USD nga 2 603 000 USD të parashikuara në kontratën fillestare
- Faza ndërtim/zhvillim (materiale dhe pajisje; mjete dhe makineri; kosto pune) me vlerë prej 7,138,000 USD (vlera është e njëjtë me atë të kontratës fillestare);

- Faza ndërtim/zhvillim me vlerë prej 306,000 USD (vlera është e njëjtë me atë të kontratës fillestare).

Rishikimi i vlerës së investimit vjen si pasojë e nevojës së ndryshimit të elementeve të veçanta të strukturës së objekteve të përfshira në fazën e përgatitjes së terrenit.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nga relatori u evidentua fakti se ndryshimi i marrëveshjes koncensionare të paraqitur do të bëjë të mundur zgjidhjen e problematikave teknike që lidhen me realizimin e një prej koncesioneve të rëndësishme për ekonominë shqiptare. Ky ndryshim mundëson vetëm reflektimin e vlerës së re të investimit dhe nuk ka për qëllim ndryshimin e kushteve të tjera thelbësore të kontratës.

Gjithashtu gjatë shqyrtimit të projektligjit nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat u ngritën disa shqetësime që konsistojnë:

- Ndikimi ose jo e rritjes së vlerës së koncesionit në rritjen e tarifave të shërbimit. Në këtë kontekst nga komisioni u evidentuan edhe rekomandimet e bëra nga Autoriteti i Konkurrencës përmes vendimit nr. 383, datë 17.11.2015.
- Prezencën e lejeve mjedisore për të vlerësuar ndikimin në mjedis të këtij ndërtimi.
- Prezencën e një studimi të mirëfilltë në momentin e lidhjes së këtij koncesioni lidhur me ndryshimet që mund të sjelli fillimi i operimit të këtij koncesioni në tregun e hidrokarbureve, ndikimin e tij në çmimin e hidrokarbureve dhe në situatën e monopolit aktualisht në Porto Romano.

Nga ana e deputetëve të opozitës u ngritën disa shqetësime që konsistojnë në:

- Prezencën e një studimi paraprak të impaktit që mund të ketë ky ndërtim në hidrovor dhe mbi mënyrën e mbrojtjes së shtratit apo grykës së hidrovorit.
- Prezencën e lejeve të duhura lidhur me ndikimin e këtij projekti mbi Muret e Portës të ndërtuara në shkullin VI e.s., sipas inventarit të Ministrisë së Kulturës.

V. Përfundime

Në fund Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, vlerësoi se kjo marrëveshje ndryshuese do të bëjë të mundur zgjidhjen e problematikave teknike që lidhen me realizimin e një prej koncesioneve të rëndësishme për ekonominë shqiptare dhe pasi shqyrtoi edhe raportin e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin me shumicë votash e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

Relator

Roland XHELILI

Kryetar

Erjon BRAÇE